



Prishtinë, 23 qershor 2020
Kodi i ZRRE-së: V_1253_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtitshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin në parcelën ngastrave Nr. 00329-56- ZK Dushanovë, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** në Komunën e Prizrenit, të datës 05.06.2020 me nr. prot. 234/20 të aplikuesit personit fizik Hashim Jonuzaj, me adresë: rruga Përparimi, Dushanovë Komuna Prizrenit, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 23 qershor 2020 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET** - kërkesa e aplikuesit personit fizik Hashim Jonuzaj për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin e ngastrës kadastrale Nr. 00329-56, ZK Dushanovë, me kapacitet të instaluar prej **10 kW**, në Komunën e Prizrenit.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi personi fizik Hashim Jonuzaj me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DPZ- 9064210 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrorj kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi personi fizik Hashim Jonuzaj do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.


A r s y e t i m





- ZRRE, me datë 05.06.2020 nga aplikuesi personi fizik Hashim Jonuzaj, ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastra kadastrave Nr. 00329-56 ZK Dushanovë, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** shifra e konsumatorit DPZ- 9064210 që do të vendosen Në objekt, në Komunën e Prizrenit.
 - Aplikuesi, s’bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 3719 të datës 29.05.2020 të lëshuar nga KEDS SH.A., dhe Përgjigjes Nr. 04-353-33936 të datës 26.05.2020 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizimit, dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Prizrenit.
 - Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit personit fizik Hashim Jonuzaj dhe dëshmimeve të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në objektin parcelën ngastra kadastrave Nr. 00329-56 ZK Dushanovë, me kapacitet të instaluar prej **10 kW** që do të vendosen në objekt, në Komunën e Prizrenit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V.** Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Prizrenit,
- KEDS SH.A.,dhe
- Arkivit të ZRRE-së.